



Ç'është besimi në

### **Ditën e Gjykimit?**

Kjo domethënë të besosh në tërë atë që ka ardhur në Kur'an dhe për të cilën na ka lajmëruar Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem!) lidhur me ngjarjet që do të ndodhin pas vdekjes, siç janë: sprovë e varrit, dënimi dhe begatitë e tij, ndodhitë e Ditës së Kijametit, si: ringjallja, llogaria, peshorja, xheneti, xhehenemi e kështu me radhë.

### **Sprovë e varrit**

Me fjalën sprovë, në këtë rast, nënkuptohet provimi i njerëzve në varret e tyre kur i thuhet njeriut: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Cili është pejgamberi yt? Allahu i forcon ata që besuan me fjalën e fortë në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atëherë, besimtari thotë: Zoti im është Allahu, feja ime është Islami dhe pejgamberi im është Muhamedi (sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem!), kurse ai që dyshonte do të thotë: nuk e di, kam dëgjuar njerëzit duke thënë diç e thashë edhe unë.

### **Dënimi dhe shpërblimi në varr**

Pas sprovës së varrit do të ketë ndëshkim ose shpërblim deri sa të bëhet Kijameti i madh. Varrin do të jetë kopsht prej kopshteve të xhenetit ose gropë prej gropave të zjarrit. Argument për



Atë ditë peshimi është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat, ata janë të shpëtuar. Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humbën vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë.[\[4\]](#)

### Fletushkat e veprave

Këto janë fletushkat, të cilat i shkruajnë melekët në këtë dunja, që janë përcjellës e shkrues të ndershëm, e të cilat do të shpërndahen Ditën e Gjykimit. Besimtari e merr librin me të djathtën e tij, ndërsa kriminelin me të majtën e tij apo pas shpine. I Lartmadhërishmi thotë:

???????? ?????????? ?????????????? ?????????? ?????????? ? ?????????????? ???  
?????????????

Kurse, mbi ju janë përcjellësit! Janë shkrues të ndershëm te All-Ilahu. Ata e dinë se çka punoni.[\[5\]](#)

Po ashtu thotë:

????????? ????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ??????????????  
???????????

E për sa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë.[\[6\]](#)

Mandej, thotë:

????????? ????? ?????????? ?????????????? ??????? ?????????????? ?????????????? ??????????????

E për sa i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës, ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim.[\[7\]](#)

### Llogaria

Allahu do t'i llogarisë krijesat për punët e tyre, qofshin të mira apo të këqija. Besimtari do të ketë

Ilogari të lehtë. I Lartmadhërishmi thotë:

???????? ???? ??????? ?????????? ?????????????? ??????????? ??????????? ???????????  
??????????

**E për sa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një Ilogari të lehtë.**[\[8\]](#)

Atij do t'i paraqiten mëkatet dhe do t'i njohë ato. Ndërsa, jobesimtari do të ketë Ilogari të rëndë dhe do të frikësohet aq shumë nga vështirësia e Ilogarisë, saqë do të shpresojë të ishte dhe. I Lartmadhërishmi thotë:

?????? ?????????? ?????????????? ??? ?????????????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ???  
????????????? ?????? ??????????????

**...në ditën kur njeriu shikon se çka i kanë sjellë duart e veta, e jobesimtari thotë: "Ah, sa mirë do të ishte për mua sikur të isha dhe."**[\[9\]](#)

## Pyetje

1. Çka domethënë besimi në Ditën e Gjykimit?
2. Çka nënkuptojmë me sprovën e varrit?
3. Çka i thuhet të vdekurit në varr?
4. Cili është argumenti lidhur me dënimin e varrit?
5. Kur do të llogariten krijesat për veprat e tyre?
6. Përse jobesimtari shpreson të ishte dhe?

Përktheu: Jusuf Kastrati

Marrë nga libri: "Et-Teuhid" - Instituti i Mësimet të Gjuhës Arabe - Universiteti "Imam" në Riad.

---

[1] Suretu Gafir: 46

[2] Berzah quhet koha ndërmjet dunjasë dhe ahiretit, përkatësisht që nga vdekja deri në ringjallje.

[3] Suretul-Mutaffifin: 4-6

[4] Suretul-A'raf: 8, 9

[5] Suretul-Infitar: 10-12

[6] Suretul-Inshikak: 7, 8

7 Suretul-Inshikak: 10,11

8Suretul-Inshikak: 7,8

9Suretu En-Nebe': 40